



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:198550

Datë: 24.11.2023

Numri i dokumentit: 04968937

C.nr.5203/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.D, nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson LB, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestuese kompensim i shujtave ditore, vlera e kontestit 814.00 euro, jashtë seance, me datë 24.11.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.D, , ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për periudhën kohore nga data 25.01.2021 deri më datën 21.11.2022, për 407 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 814.00€ (tetëqindë e katrëmbëdhjetë euro), me kamatë ligjore 8% vjetore, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë gjegjësisht datë 19.09.2023 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditësit A.D, , në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 Euro, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pran kësaj gjykate me datën 19.09.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e shujtave – ushqimit. Ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës punëtor teknik në SH.F.M.U. “Skëndija”, në fshatin Hajvali - Prishtinë. Ka shtuar se e paditura nuk e ka bërë kompensimin për shujtë ditore konform nenit 35 par.7 të KKA. Ka shtuar se baza ligjore e kërkesëpadisë së paditësit gjen mbështetje në nenin 90 të Ligjit të Punës, andaj, konform nenit 8 të LMD-së, pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit. Nga këto arsye ka kërkuar kompensimin e shujtave për paditësin për periudhën kohore nga data 25.01.2021 e deri me datën 21.11.2022, saktësisht për 407 ditë në shumën e përgjithshme prej 814.00 euro, dhe atë

me kamatë ligjore prej 8%, deri në pagesën definitive të detyrimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të pranuar në Gjykatë me dt.10.10.2023, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, duke shtuar tutje se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 398 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykata konstatoi se paditësi A.D., është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës Punëtor teknik, në SH.F.M.U. “Shkëndija”, në fshatin Hajvali - Prishtinë. Po ashtu, u vërtetua se përgjatë periudhës kohore 25.01.2021 – 21.11.2022, paditësi ka qenë prezente në vendin e punës për 407 ditë pune. Faktet e tilla vërtetohen në bazë të kontratës së punës, 03.Nr.719/143, të dt.16.03.2016, të lidhur mes palëve ndërgjyqëse si dhe vërtetimit për ditët e pranisë në punë nr.prot.69/VIII, të dt.24.04.2023, të lëshuar nga SH.F.M.U ‘Shkëndija’, në fshatin Hajvali - Prishtinë. Provave materiale të lartëcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimine autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkuara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Kjo për faktin se kërkesapadia e paditësit për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore nga data 25.01.2021, e deri me datën 21.11.2022, gjen mbështetje në Kontratën në fjalë.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me

dispozitën nga neni 35 par.7 të Kontratës së lartëcekur, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”.*

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësi është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyimeve mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Referuar dispozitave të lartëcekura, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, e mbi këtë bazë, është bërë përllogaritja në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2 euro për ditë pune, e bazuar në faktin se nga provat e administruara u vërtetua se paditësi për periudhën kohore të specifikuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka gjithsejt 407 ditë të prezencës në punë, të njejtës i takon kompensimi në shumën e përgjithshme prej 814.00 Euro. Bazuar në këto konstatime, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në dy rrethana: fillimisht në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, si dhe lidhur me faktin se gjatë përgaditjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit.

Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se e drejta e paditësit për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: *“Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”.* Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e këtyre Kontratës, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratave Kolektive të lartëcekura, në njërin anë janë paraparë të drejta për njërin palë, e në anën janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditësit për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohen pengesë që paditësi t’i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht datë 19.09.2023, e deri në pagesën definitive.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1 të LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësit, t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve deri në këtë fazë të procedurës në vlerë të përgjithshme prej 124.00 Euro dhe atë: 104.00 Euro në emër të përpilimit të padisë dhe 20.00 Euro në emër ta taksës gjyqësore për padi.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 160 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
C.nr.5203/23, datë 24.11.2023

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.